



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

---

**VENDIM**

**Nr. 31, Datë 28.05.2015**

**PËR**

**DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN NR. 12, DATË 30.01.2013 “PËR  
HARTIMIN, NDJEKJEN, MIRATIMIN DHE ZBATIMIN E BUXHETIT TË  
AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 8, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 128 të Kodit të Procedurës Administrative, me propozim të Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

- 1. Miratimin e disa ndryshimeve në Rregulloren nr. 12, datë 30.01.2013 “Për hartimin, ndjekjen, miratimin dhe zbatimin e buxhetit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”, e ndryshuar, sipas materialit bashkëlidhur.**
- 2. Ngarkohen Departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR**

**Pajtim MELANI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

**Enkeleda SHEHI**

**Ndryshimet në rregulloren nr. 12, datë 30.01.2013 “Për hartimin, ndjekjen, miratimin dhe zbatimin e buxhetit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”, e ndryshuar.**

a) “Në të gjithë përmbajtjen e rregullores emërtesa “Kryetar” zëvendësohet me emërtesën “Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv”.

b) “Në të gjithë përmbajtjen e rregullores emërtesa “Nënkryetar” zëvendësohet me emërtesën “Nëndrejtor Ekzekutiv”.

c) “Në shtojcat bashkëlidhur rregullores bëhen ndryshimet si më poshtë:

c/1 Në shtojcën nr.1 shtohet Zëri II.10.29 “Shpenzime për Qendrën e Edukimit” me elementët:  
-shpenzime transporti me jashtë për trajnerët e huaj  
-shpenzime hoteli për trajnerët e huaj  
- shpenzime për pagesë për trajnerët e huaj  
-shpenzime për pagesë për trajnerët vendas  
- shpenzime të tjera;

c/2 Në shtojcën nr.2 shtohet pika 24 “Planifikimi për shpenzimet e Qendrës së Edukimit”;

c/3 Në shtojcën nr. 3, pasqyra 5(Projektbuxheti i shpenzimeve për vitin N) shtohet Zëri II.10.29 “Shpenzime për Qendrën e Edukimit” me elementët përkatës;

c/4 Në shtojcën nr. 4 pasqyra 3(Realizimi i shpenzimeve për periudhën) shtohet Zëri II.10.29 “Shpenzime për Qendrën e edukimit” me elementët përkatës.